

Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturale, Peizazh kulturor**

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë

(Fotografi pamje karakteristike, dt...)



Pamje jug-perëndimore e Hidroelektranës_Prill 2015

Datimi/et (Relativ/e) : 1926-1928 (Shek XX)

Periudha/t historike: Periudha Moderne

Adresa: Vendndodhja, Qyteti/Fshati, Komuna

**Gryka e Lumbardhit, 2.5 km në lindje të Prizrenit, gjatë aksit rrugor Prizren - Brezovicë,
20000, Prizren**

Lloji i asetit të propozuar

(Kategoria ligjore dhe Nënkatëgoria sipas nenit 2 të LTK)

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturale;

Nënkatëgoria: Monument / Ansambël

Numri unik : 001425

Numri i regjistrimit në KKTK:

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/referenca e dokumentit/aktit nëse ka
(Akti i mëhershëm nëse ka)

Vendim Nr. 50/77

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

(Të përshkruhet arsyetimi se përse aset i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përherëshme.)

Hidroelektrana paraqet një ndërtesë me rëndësi në historinë e zhvillimit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe njërin prej objekteve të para industriale me një trajtim të veçantë arkitektonik. Hidroelektrana në aspektin arkitektural paraqet një shembull të veçantë ku është ngërthyer ndikimi i stilit modern i ndërtimit me shfrytëzimin e materialeve lokale dhe bashkë-dyzimin në ambientin ku është i vendosur. Në aspektin shkencor dhe teknologjik, kjo ndërtesë paraqet një kthesë të rëndësishme në historinë urbane të Prizrenit, pasi që paraqet fillimin e fazës së elektrifikimit të qytetit.

Hidroelektrana me pozitën e saj karakteristike, harmoninë me ambientin rrethues, karakteristikat arkitektonike si ndërtesë me arkitekturë të veçantë të fillimit të shek. XX, dhe me elementet origjinale të ruajtura paraqet një monument me vlerë të madhe artistike, historike, shoqërore, rariteti dhe shkencore jo vetëm për Kosovën, por në përgjithësi për rajonin.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aset

(Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nenit 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS)

Vlerat Historike - Ndërtesa e hidroelektranës ndërlidhet ngushtë me fillet e elektrifikimit të Prizrenit, dhe paraqet një dëshmi të historisë së zhvillimit të prodhimit të energjisë elektrike. Vlera historike e ndërtesës ndërlidhet me faktin që këtu ende janë të ruajtura makineria origjinale dhe hapësirat përcjellëse që dëshmojnë për mënyrën e funksionimit të hidroelektranës.

Vlerat artistike –Hidroelektrana paraqet një shembull të trajtimit reprezentativ të një objekti industrial. Paraqet edhe fillet e aplikimit të arkitekturës moderne dhe ndikimin evropian në arkitekturën Prizrenase. Ndërtesa ende ruan integritetin e formës dhe funksionit. Trajtimi i formës, vendosja në lokacion, përzgjedhja e materialeve, e përbëjnë vlerën artistike të saj. Vlera artistike paraqet ndër vlerat kryesore të hidroelektranës.

Vlerat shoqërore – Ndërtesa e hidroelektranës ka luajtur rol të rëndësishëm në shoqërinë Prizrenase. Kjo ndërtesë paraqet simbolin e kalimit nga jeta primitive në atë moderne, duke e zëvendësuar llambën e vajgurit me atë elektrike.

Vlerat shkencore –Hidroelektrana paraqet një shembull faktik të zhvillimit të energjisë elektrike në fillimet e shekullit të 20-të. Vetë ndërtesa paraqet një fakt shkencor të mënyrës së prodhimit të rrymës elektrike përmes forcës së ujit. Lokacioni, ndërlidhja me kanalin e ujit që rrjedh nga shkëmbi, gjeneratorët për prodhimin e ujit, janë fakte që paraqesin një shembull të zhvillimit në historinë e prodhimit dhe transmetimit të rrymës elektrike. Krahas vlerës artistike, objekti ka vlerë të lartë shkencore.

Vlera ambientale – Zona ku gjendet objekti së bashku me hidroelektranën paraqet një bashkë-dyzim të trashëgimisë kulturore me atë natyrore. Ambienti rrethues ku është i vendosur

kompleksi, ka vlerë të lartë ambientale, ku gryka e Lumbardhit së bashku me malet e Sharrit krijojnë një harmoni të plotë ndërmjet arkitekturës, teknologjisë dhe natyrës.

Rariteti: Hidroelektrana e Prizrenit është njëra ndër ndërtesat e para industriale të ndërtuara për gjenerimin e rrymës elektrike në Kosovë, në fillim të shek. XX. Për nga trajtimi arkitektonik, dimensionet, teknologjisë së prodhimit të rrymës paraqet një shembull unik në territorin e Kosovës.

Propozuesi:

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor Prizren – MKRS

Emri/Mbiamri: Samir Hoxha

Nënshkrimi _____

Adresa dhe kontakti: Adresa: Rruga "Marin Barleti" nr. 11, 20 000 Prizren

Tel: 029/244-487

Mob. +37744/216-010

Email: samirhoxha11@gmail.com

samir.hoxha@rks-gov.net

Data : .../.../.....

Bashkëngjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt.../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

(Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit)

Komuna e Prizrenit, aksi rrugor Prizren – Brezovicë, kilometri 2.5 në lindje, 20000

Qyteti i Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në rrugën që lidhte më parë bregdetin verior të tokave shqiptare dhe qendrat e tij qytetëro- tregtare me rajonet e brendshme të Kosovës dhe të Ballkanit.

Prizreni është i njohur që nga antikiteti si një vend unik në Ballkan për vlerat e trashëgimisë kulturore, të civilizimeve dhe religjioneve të ndryshme. Falë pozitës së favorshme gjeografike, gërshetimit harmonik të kulturave gjatë historisë dhe një numri të lakmueshëm të monumenteve të trashëgimisë kulturore të të gjitha kohërave, qyteti i Prizrenit me plot të drejtë mban epitetin e "qytetit muze" apo "muzeut nën qiellin e hapur", dhe radhitet si njëra ndër qytetet më të bukura të Kosovës.

Nga e kaluara, qyteti i Prizrenit ka trashëguar një numër të madh objektesh kulturo -historike. Më të rëndësishme janë : Kompleksi i Shatërvanit, Nënkalaja, Marashi, Kalaja, Kisha e Shën Premtes, Kisha e Shën Shpëtimit, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia e Sinan Pashës, Hamamet, krojet publike, ura e gurit dhe një numër i madh i shtëpive tradicionale të trashëguar ndër shekuj.¹

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNeëRef I)

Lat: 7480340.653; Lon: 4673596.747

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Hidroelektrana është e vendosur në lindje të qytetit të Prizrenit, në kompleksin memorial Gryka e Lumbardhit. Ndodhet në kilometrin e tretë të rrugës Prizren – Brezovicë, në bregun e djathtë të Lumbardhit.


Kompleksi memorial Gryka e Lumbardhit gjendet në lindje të Prizrenit dhe paraqet një pasuri natyrore të gërshetuar me objektet e kulturës materiale. Ky kompleks për shkak të rëndësisë si hapësirë me karakteristika të veçanta natyrore dhe kulturore, është vënë nën mbrojtje me vendimin nr. 633-12/1977 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.²

Kompleksi karakterizohet me këtë përbërje: **Gryka e Lumbardhit** me një gjatësi prej 7 km që fillon nga fshati Reçan e deri në hyrje të Prizrenit; **Ura e vjetër e gurit në grykën e Lumbardhit** – e cila daton nga shekulli XV dhe lidh brigjet e Lumbardhit; **Kompleksi i Manastirit të Kryeengjëjve** – në këtë kompleks gjenden Kështjella e Epërme, Kisha e Shënkollit, Kisha e Kryeengjëjve, tryezaria, konaqet me kthinat ekonomike dhe ura; **Kështjella e epërme** e quajtur ndryshe si *Drvengrad* apo *Kiz Kalasi* (Kalaja e Vashave), e ndërtuar gjatë shekujve V-VI, gjendet në një lartësi prej 120 metrave; **Hidroelektrana** gjendet pranë Kompleksit të Manastirit të Kryeengjëjve, në bregun e djathtë të Lumbardhit; dhe **Monumentet**

¹ Ueb faqja zyrtare e Databazës së trashëgimisë Kulturore të Kosovës, http://dtk.rks.gov.net/tkk_trashegimia.aspx?qyteti=20

² Shukriu M., *Prizreni i lashtë morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale*, Prizren:, 2001, 189.

tjera – përgjatë rrjedhës së Lumbardhit gjenden gjurmët e varreve parahistorike dhe bizantine, të cilët nuk janë zbuluar ende. Në vijim të rrjedhës gjenden mulliri i familjeve Dehiri dhe Hapçiu, dhe nën to varri i paidentifikuar i Musa Shehzades. Në hyrje të qytetit, në bregun e djathtë gjendet një shpellë mesjetare me freska.



Pamje ajrore e Kompleksit Memorial Gryka e Lumbardhit

Parcela ku gjendet Hidroelektrana, në anën jugore kufizohet me shpatin guror të malit, në anët lindore, veriore dhe perëndimore me lumin Lumbardhi, dhe në anën veriore pas Lumbardhit me rrugën.

Pranë Hidroelektranës, në krahun lindor gjenden Kompleksi i manastirit të Kryeëngjujve. Zona mbrojtëse e Hidroelektranës e përcaktuar sipas Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, nenit 6 (paragrafi 6.4) me rreze 50 metra nga perimetri i monumentit, në anën lindore përputhet me zonën mbrojtëse të Manastirit të Kryeëngjujve.

Perimetri i asetit të propozuar: _____ ha

Zona rrethuese për mbrojtje/Buffer zone: _____ ha

Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- *Planet e situacionit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese P=1:500 dhe 1:200 (nëse është e aplikueshme).*
- *Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.*

- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratigrafinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- Përshkrimi i asetit të propozuar nga momenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.
- Në rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël/tërësi dhe fushë e konzervimit arkitektural) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës, strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit, stili arkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimi dhe aspektet tjera ndërlidhëse të lokacionit të asetit, siç janë: terreni, oborri, mobiliet, pikturat, ikonat, mbishkrimet epigrafike, mjedisi rreth tij, etj.

Në ambientin piktoresk të Grykës së Lumbardhit, 2.5 km në lindje të Prizrenit gjendet ndërtesa e Hidroelektranës. Është ndërtuar në vitin 1926-28 me kontributin e qytetarëve dhe kredive bankare. Ndërtesa është projektuar dhe ndërtuar nga një kompani austriake. Objekti ka pasur elementet moderne të asaj kohe: turbinat e ujit, pjesën për pastrimin e ujit nga mbeturinat, kanalën, pajisjet për përcjelljen e ujit gjer në turbinë dhe gjeneratorin me fuqi 160 KW. Për shkak të kërkesës së madhe të energjisë elektrike më 1936 është lëshuar në qarkullim gjeneratori i dytë me kapacitet të njëjtë.

Konfiguracioni i terrenit dhe pozita e burimit të ujit kanë ndikuar në vendin e ndërtimit, por gjithashtu lokacioni është zgjedhur me kujdes nga ana e projektuesit të objektit. Krahas përshtatjes në terren gjithashtu edhe arkitektura e objektit është përshtatur rreth nës së tij. Ndërtesa është formësuar në përdhes dhe kat.

Qasja në ndërtesë bëhet kah ana veriore përmes urës nga betonarmeja, të ndërtuar njëkohësisht me ndërtimin e ndërtesës. Qasja në përdhes bëhet nëpërmjet portës së drurit, kah ana veriore. Në përdhes gjenden dy hapësira: vendi ku gjenden gjeneratorët, dhe hapësira e makinerisë. Pas shndërrimit në muze dhoma e makinerisë shfrytëzohej si hapësirë e ekspozimit, ku janë të ekspozuara ekspozatat që tregojnë zhvillimin e elektroekonomisë në Kosovë. Kycja në katin e parë bëhet përmes shkallëve të jashtme, të vendosura në murin lindor të objektit. Në katin e parë gjendet dhoma e kujdestarit të hidroelektranës, e cila pas shndërrimit në muze shfrytëzohej si bufe, hapësira e kulmit, dhe depo. Fillimisht një pjesë e katit të parë ka qenë e mbuluar me kulm të rrafshët, dhe qasja në kulm realizohej nga ana veriore e dhomës së inxhinierit. Më vonë kulmi i rrafshët është mbuluar me kulm të pjerrtë një uJOR të mbuluar me tjegulla argjile.

Kurse në katin e dytë, një pjesë e kulmit është i rrafshët dhe shfrytëzohej si terrasë verore.

Në oborr, krahas, urës dhe bregut të lumit, gjenden trafostacioni i vjetër dhe nyjet sanitare të ndërtuara në afërsi të kompleksit.

Arkitekti austriak ka zgjedhur vendin më të përshtatshëm për shfrytëzimin e ujit dhe është munduar që objektin industrial ta përshtatë me ambientin duke dhënë formën e një kështjelle si

inspirim nga Kështjella e Epërme që gjendet në afërsi. Në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin stil janë ndërtuar edhe tri trafo-stacione që kanë shpërndarë rrymën nëpër qytetin e Prizrenit.

Materiali kryesor i ndërtimit është guri gëlqeror me ngjyrë të hirtë të çeltë, që është sjellë nga shkëmbinjte në Grykën e Lumbardhit. Këndet e mureve nga guri, kufizohen nga shtresa e punuar me tulla të kuqe, të cilat paraqiten edhe rreth dritareve dhe dyerve, në formë kornize. Gardhi i terrasës është punuar nga shtylla të ulëta nga tullat, duke dhënë pamjen e një objekti fortifikues. Materiali i themeleve është nga guri gëlqeror pa material lidhës ndërmjet tyre. Dritaret në përdhes, janë nga kombinimi i kornizës së jashtme nga druri, dhe ndarjet e brendshme nga metali. Dyert janë nga druri, kurse ajo në hyrje të kompleksit është punuar nga metali.

Shkallët e jashtme, që paraqesin lidhjen e vetme për në katin e parë, janë të ndërtuar nga betoni i armuar. Gardhi i shkallëve gjithashtu është i punuar nga metali, me një nivel të lartë të përpunimit artistik. Gardhi i shkallëve dhe dera e metalit në hyrje veçohen me teknikën tradicionale të përpunimit të elementeve nga hekuri, me ç'rast lidhja e pjesëve të ndryshme është bërë me *bagllama* (lidhje) të farkëtuara me dorë.

Konstruksioni meskatësh që ndan katin përdhesë nga kati i parë, është nga druri, në formë të trarëve të vendosura në një drejtim. Kurse dhoma e mbikëqyrësit apo byfeja, është mbuluar me konstruksion nga betoni i armuar. Dyshemeja e përdhesës është mbuluar me pllaka qeramike, kurse në kat me dërrasa. Konstruksioni i kulmit është nga druri, me një ramje, i mbuluar me tjegulla të kuqe.

Hidroelektrana ka furnizuar qytetin e Prizrenit me rrymë elektrike prej vitit 1929 deri në vitin 1973. Në vitin 1979 kjo ndërtesë e rëndësishme për historinë industriale të qytetit është shndërruar në Muze të Energjisë Elektrike të Kosovës. Gjatë adaptimit të ndërtesës në muze janë bërë punët restauruese, në ndërtesë dhe oborr.

Muzeu i Energjisë Elektrike i vendosur në një ndërtesë historike “Hidroelektranë” paraqet një shembull unik për Kosovën, për trajtimin e objekteve industriale si trashëgimi kulturore. Muzeu ka funksionuar deri në mes të viteve 1980'ta.

***Shtojcë 3:** Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Funksioni aktual: Hidroelektrana pas ndërhyrjeve konservuese të fundit që janë kryer gjatë viteve 2012-2013, nuk është në funksion dhe qëndron e mbyllur.

Pronësia: Hidroelektrana është pronë e ish Entit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, respektivisht Qendrës së sotme Rajonale për trashëgimi Kulturore në Prizren (QRTK Prizren). Kjo ndërtesë është nën përgjegjësinë dhe kujdesin e QRTK Prizrenit.

Shfrytëzuesit aktual: Pas përmbylljes së projektit të konservimit në vitin 2013, ndërtesa nuk është revitalizuar dhe aktualisht nuk shfrytëzohet.

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit

- *Përshkrimi i formësimit të asetit nga themelimi deri në gjendjen aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet domethënëse në historinë e konservimit.*
- *Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për: monumente, ansamble, fusha të konzervimit arkitektural, lokalitete dhe rezervate. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartëshënuara, duke përfshirë aspektin e historisë dhe kronologjisë së aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror.*

Funksionet:

Nga viti i ndërtimit e deri më sot, Hidroelektrana ka pasur funksione të ndryshme.

- **Vitet 1945-1973** – ka funksionuar si hidroelektrana e cila ka furnizuar Prizrenin me energji elektrike.
- **1973 - 1975** – për shkak të kapacitetit të pavolitshtëm kundrejt rrjetit të riformuar të sistemit elektroenergjetik në hapësirën e Kosovës, Hidroelektrana ndalon së funksionuari dhe humb funksionin primar. Në vitin **1975**, arrihet marrëveshja ndërmjet kompanisë prodhuese “Elektrokosova” në Prishtinë, Drejtorisë krahinore për kulturë dhe zhvillim, në Prishtinë dhe Entit për urbanizëm dhe mbrojtje të monumenteve kulturore dhe natyrore, në Prizren, për themelimin e Muzeut të Elektro-ekonomisë së Kosovës në Prizren.
- **1975-1976**- fillojnë përgatitjet për hapjen e muzeut të elektro-ekonomisë, me ç’rast është bërë incizimi fotografik i objektit, është përgatitur harta gjeografike në relief në të cilën paraqiten nyjet e prodhimit dhe të përcjelljes së energjisë elektrike në Kosovë, konservimi i planeve origjinale të objektit të hartuar nga firma Vienneze, hartimi i projektit të konservimit dhe restaurimit të objektit në muze.
- **1977** – Hidroelektrana është shpallur monument nën mbrojtje të shtetit, që ka mundësuar realizimin e punëve restauruese dhe mirëmbajtëse.
- **1979 - 1981** – Hidroelektrana shndërrohet në Muzeun e Elektro-ekonomisë së Kosovës. Muzeu përfshinte: **në katin përdhes** - stabilimentet e centrales, të dy gjeneratorët, materiali arkivor mbi fillet dhe përfundimin e ndërtimit të objektit; fotografitë e objekteve të elektro-ekonomisë së Kosovës, harta gjeografike në relief në të cilën paraqiten nyjet e prodhimit dhe të përcjelljes së energjisë elektrike në Kosovë, fotografitë e mjeshtërive të parë elektricist në Prizren, kino-aparatura e parë e Prizrenit, e firmës ‘Ernemini’, dhe prodhime të ndryshme të elektroekonomisë së asja kohe në Kosovë; në oborr të objektit – trafostacioni me formë interesante i sjellur nga Ferizaji, pjesët e centraleve prej fshatit Mushnikovë dhe mbeturinat e centralit me gaz prej Gjilani; **kati i parë dhe terrasa** – karakter rekreativ – bufeja dhe restorani.
- **1981 – 2011** – Hidroelektrana edhe me statusin e muzeut, është lënë në mëshirë të kohës, pa ndonjë funksion apo mirëmbajtje.
- **2012- 2013** – Ndërhyrjet konservuese.
- **2014**-sot – Ndërtesa qëndron e mbyllur pa ndonjë funksion të caktuar.

Transformimet – Ndërhyrjet konservuese:

Nga viti i ndërtimit e deri më sot, ndërtesa ka pësuar ndërhyrje të numërta konservuese:

- **Vitet 1945-1975** – Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje:
 - o Ndërtimi i kulmit të pjerrtë, me konstruksion të drurit me mbulesë me tjegulla, mbi dhomën e gjeneratorëve;
 - o Suvatimi i gardhit të terrasës me llaç çimentoje.
- **Vitet 1975-1979** - me rastin e adaptimit të ndërtesës në Muze, janë bërë disa ndërhyrje:
 - o Largimi i trafostacionit nga dhoma në përdhes dhe vendosja e makinerisë në oborr të hidroelektranës.
 - o Shtruarja e dyshemesë së dhomës së makinerisë me pllaka qeramike.
 - o Largimi i derës që lidhë dhomën e gjeneratorëve me dhomën e makinerisë.
 - o Adaptimi i dhomës ku gjendej makineria si hapësirë për ekspozimin e ekspozateve të elektroekonomisë.
 - o Riparimi i kulmit të pjerrtë, me konstruksion të drurit me mbulesë me tjegulla, mbi dhomën e gjeneratorëve.
 - o Ri-suvatimi i gardhit të terrasës me llaç çimentoje dhe përforcimi me profil metalik për ta adaptuar për shfrytëzimin e terrasës si terrasë verore e bufesë.
 - o Largimi i murit ndarës në katin e parë, dhe adaptimi i kësaj hapësire për shfrytëzim si bufe.
 - o Ndërrimi i dritareve në katin e parë
 - o Adaptimi i hapësirës së nënkuilmit, për shfrytëzim si kuzhinë e bufesë.
 - o Ndërtimi i pllakës nga betoni për mbylljen e boshllëkut ku gjenden turbinat.
 - o Instalimi i elementeve përcjellëse për ujësjellës, në katin e parë.
 - o Rregullimi i oborrit, dhe ndërtimi i shtigjeve për ecje kah ana lindore në kufi me murin rrethues.
 - o Ndërtimi i nyjes sanitare në oborr.
- **Vitet 1981-2010** - gjatë kësaj periudhe në ndërtesë janë bërë disa meremetime të vogla:
 - o Shtruarja e shtresës së hidroizolimit në terrasë;
 - o Mbyllja e oxhakut që ka qenë në dhomën e mbikëqyrësit të hidroelektranës / bufesë;
 - o Riparimi i shtresës së suvatimit në gardhin e terrasës
- **Vitet 2011-2012** – Hartimi i planit të konservimit të Hidroelektranës nga ekipi i përbërë nga profesionistët e QRTK Prizrenit dhe OJQ CHwB (Trashëgimi Kulturorë pa Kufij).
- **Vitet 2012-2013** - Implementimi i punimeve konservuese në strukturën e hidroelektranës - Projekt i financuar nga fondi i ambasadorëve të SHBA-së.

Fazat kryesore ndërtimore:

Në bazë të hulumtimeve që janë bërë në arkiv, analizës së gjurmëve të ndërtimit në objekt dhe intervistave me punëtorët e vjetër të hidroelektranës, janë përcaktuar fazat e ndërtimit dhe transformimet e bëra në objekt. Në historinë e ndërtimit të këtij objekti, janë përcaktuar katër faza vendimtare që kanë pasur ndikim në formën dhe funksionin e tij.

Faza e parë: vitet 1927-1945 – faza e funksionimit të objektit si hidroelektranë. Paraqet fazën e parë të ndërtimit të objektit e cila trajtohet si faza origjinale. Si burim i kësaj faze janë gjetur dy fotografi të vjetra dhe planet origjinale të hartuara nga firma Vienneze.

Faza e dytë: vitet 1945-1975 – faza e funksionimit të objektit si hidroelektranë. Gjatë kësaj faze janë bërë disa ndërhyrje në objekt për plotësimin e nevojave dhe kushteve atmosferike. Si burim

për hulumtimin e ndërhyrjeve gjatë kësaj faze janë zhvilluar intervista me punëtorët e hidroelektranës të cilët e kanë përshkruar objektin.

Faza e tretë: vitet 1975-1979 – faza e shndërrimit të hidroelektranës në Muzeun e elektroekonomisë së Kosovës. Para adaptimit të objektit në muze, është bërë matja e gjendjes në vitin 1974, dhe projekti është hartuar nga arkitekti i Institutit për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren, Serafin Nikolic. Ndërhyrjet e bëra gjatë kësaj periudhe janë dokumentuar në arkivin e Institutit për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren.

Faza e katërt: vitet 1981-2010 – gjatë kësaj periudhe në objekt janë bërë ndërhyrje minimale. Në vitin 2005, janë bërë disa meremetime, me rastin e tentimit të ri-funksionimit të katit të parë si bufe.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet asetit, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza analoge e aseteve të njëjta në nivelin lokal, shtetëror dhe më gjerë.*
- *Autenticiteti/Integriteti*

Deklarata e rëndësisë

Hidroelektrana paraqet një ndërtesë me rëndësi në historinë e zhvillimit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe njërin prej objekteve të para industriale me një trajtim të veçantë arkitektonik. Si një monument industrial nga periudha e hershme moderne, ndërtesa është një ndër shembujt unik të kësaj tipologjie në Kosovë dhe rajon. Specifika kryesore e saj është bashkëdyzimi i teknologjisë, arkitekturës dhe natyrës në një ndërtesë industriale.

Hidroelektrana me pozitën e saj karakteristike, harmoninë me ambientin rrethues, karakteristikat arkitektonike si ndërtesë me arkitekturë të veçantë të fillimit të shek. XX, dhe me elementet origjinale të ruajtura paraqet një monument me vlerë të madhe artistike, historike, shoqërore, rariteti dhe shkencore jo vetëm për Kosovën, por në përgjithësi për rajonin.

Vlerat:

Vlerat Historike - Ndërtesa e hidroelektranës ndërlidhet ngushtë me fillet e elektrifikimit të Prizrenit, dhe paraqet një dëshmi të historisë së zhvillimit të prodhimit të energjisë elektrike. Vlera historike e ndërtesës ndërlidhet me faktin që këtu ende janë të ruajtura makineria origjinale dhe hapësirat përcjellëse që dëshmojnë për mënyrën e funksionimit të hidroelektranës.

Vlerat artistike – Hidroelektrana paraqet një shembull të trajtimit reprezentativ të një objekti industrial. Paraqet edhe fillet e aplikimit të arkitekturës moderne dhe ndikimin evropian në arkitekturën Prizrenase. Ndërtesa ende ruan integritetin e formës dhe funksionit. Trajtimi i formës, vendosja në lokacion, përzgjedhja e materialeve, e përbëjnë vlerën artistike të saj. Vlera artistike paraqet ndër vlerat kryesore të hidroelektranës.

Vlerat shoqërore – Ndërtesa e hidroelektranës ka luajtur rol të rëndësishëm në shoqërinë Prizrenase. Kjo ndërtesë paraqet simbolin e kalimit nga jeta primitive në atë moderne, duke e zëvendësuar llambën e vajurit me atë elektrike.

Vlerat shkencore – Hidroelektrana paraqet një shembull faktik të zhvillimit të energjisë elektrike në fillimet e shekullit të 20-të. Vetë ndërtesa paraqet një fakt shkencor të mënyrës së prodhimit të

rrymës elektrike përmes forcës së ujit. Lokacioni, ndërlidhja me kanalin e ujit që rrjedh nga shkëmbi, gjeneratorët për prodhimin e ujit, janë fakte që paraqesin një shembull të zhvillimit në historinë e prodhimit dhe transmetimit të rrymës elektrike. Krahas vlerës artistike, objekti ka vlerë të lartë shkencore.

Vlera ambientale – Zona ku gjendet objekti së bashku me hidroelektranën paraqet një bashkë-dyzim të trashëgimisë kulturore me atë natyrore. Ambienti rrethues ku është i vendosur kompleksi, ka vlerë të lartë ambientale, ku gryka e Lumbardhit së bashku me malet e Sharrit krijojnë një harmoni të plotë ndërmjet arkitekturës, teknologjisë dhe natyrës.

Rariteti: Hidroelektrana e Prizrenit është njëra ndër ndërtesat e para industriale të ndërtuara për gjenerimin e rrymës elektrike në Kosovë, në fillim të shek. XX. Për nga trajtimi arkitektonik, dimensionet, teknologjisë së prodhimit të rrymës paraqet një shembull të rrallë në territorin e Kosovës.

Analiza analoge e asetëve të njëjta në nivelin lokal, shtetëror dhe më gjerë

- Në nivel vendor, në qoftë se analizohen ndërtesat industriale për prodhim të energjisë elektrike, qofshin ato termoelektrana apo hidroelektrana, të cilët janë ndërtuar në fillim të shek. XX në territorin e Kosovës, mund të përfundojmë se Hidroelektrana e Prizrenit dallohet për nga madhësia, volumi, dhe trajtimi arkitektonik nga ato të ndërtuara në Ferizaj (centrali i parë elektrik në vitin 1922), Prishtinë (termoelektrana e parë në vitin 1927), Mirovicë (Hidroelektrana e parë në vitin 1927), Pejë (elektrana me përmasa të vogla në vitin 1928), dhe më pas në Gjilan (centrali elektrik në vitin 1932) dhe Gjakovë (centrali elektrik në vitin 1937).

- Në nivel rajonal, në aspekt të trajtimit arkitektonik, teknologjik dhe vendosjes në ambient rrethues, Hidroelektrana e Prizrenit mund të krahasohet me Hidroelektranën në qytetin Leskovac të Serbisë (edhe pse kjo e fundit e ndërtuar me përmasa dhe kapacitet më të madh) dhe hidroelektranën e ndërtuar në Cetinje, Mal i Zi në vitin 1905.³

Autenticiteti/Integriteti

Përkundër ndërhyrjeve konservuese gjatë viteve, Hidroelektrana ka ruajtur autenticitetin dhe integritetin strukturor dhe formësor në një nivel të lartë. Në Hidroelektranë janë ruajtur fazat kryesore të ndërtimit, kryesisht ajo origjinale. Nga faza origjinale janë ruajtur struktura e themeleve dhe e mureve, konstruksioni meskatësh në katin e parë, elementet e enterierit, sikurse gjeneratorët, tabelat për kontrollim të rrymës, kanali i ujit, dritaret dhe dera në përdhës, porta e hekurt në hyrje, dhe gardhi metalik i shkallëve.

Ndërhyrjet e kryera gjatë fazës së dytë, tretë dhe të katërt të cilët kanë cenuar integritetin e asetit janë larguar dhe zëvendësuar.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit*
- *Përshkrimi i gjendjes teknike*

³ Cvetkovic B., *Elektrifikacija Srbije od Cetinje do Cerdapa*, Novi Sad: Dnevnik, 1979.

- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkëkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*

Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes së elementeve origjinale

Në hidroelektranë janë ruajtur elementet që i përkasin fazës fillestare. Këtu mund të përmenden:

- Struktura e mureve dhe e themeleve;
- Konstruksioni meskatësh nga betoni i armuar i cili mbulon hapësirën e katit të parë;
- Dera dhe dritaret në përdhës;
- Porta metalike në hyrje, së bashku me konstruksionin e urës;
- Gardhi metalik i shkallëve;
- Elementet e enterierit. sikurse: gjeneratorët, tabela kontrolluese;
- Pajisjet teknologjike përcjellëse: kanali i ujit dhe pajisjet tjera.

Përshkrimi i gjendjes teknike: Gjendja & Konservimi i lokalitetit

Pas përfundimit të ndërhyrjeve konservuese në vitin 2013, Hidroelektrana në përgjithësi është në gjendje stabile.

Në vitin 2011-2012 është hartuar Projekti i Konservimit, i cili ka përfshirë një studim të hollësishëm të gjendjes aktuale të ndërtesës, analizën e fazave të ndërtimit, analizën e dëmtimeve kryesore strukturale, analizën e funksionimit të ndërtesës si Muze dhe propozimet për ndërhyrje konservuese së bashku me propozimin për ri-funksionalizim të ndërtesës si Muze apo hapësirë edukativo-kulturore.

Ndërhyrjet konservuese janë kryer gjatë viteve 2012-2013 me ç'rast janë realizuar këto punë:

- Përforcimi i themeleve nëpërmjet unazës nga betonarmeja;
- Ri-ndërtimi i nyjeve sanitare për të plotësuar kushtet e qasjes së lehtë për të gjithë vizitorët;
- Përforcimi i dyshemesë në dhomën e ekspozitës në katin përdhës më unazë nga betonarmeja, dhe vendosja e dyshemesë së re me të gjitha shtresat e nevojshme;
- Konservimi i pllakave qeramike origjinale në dhomën e gjeneratorëve në përdhës;
- Përforcimi struktural i çarjeve të paraqitura në strukturën e mureve;
- Pastrimi i gurëve në fasadë;
- Ri-ndërtimi i konstruksionit meskatësh nga druri, ndërmjet përdhësës dhe katit të parë;
- Vendosja e shtresës së re të dyshemesë nga dërrasat në katin e parë;
- Konservimi i konstruksionit meskatësh nga betoni i armuar mbi katin e parë, dhe ndërtimi i një konstruksioni të ri meskatësh mbi atë origjinale, me qëllim të bartjes së ngarkesave në konstruksion të ri;
- Ri-ndërtimi i kulmit një-ujor;
- Rindërtimi i pjesshëm i kurorës së terrasës nga tulla të plota argjile;
- Ri-ndërtimi i shkallëve të jashtme, të cilët janë vërtetuar se i përkasin një faze më të vonshme. Krijimi i hapësirës ajrore nën strukturën e shkallëve me qëllim të evitimit të depërtimit të lagështisë në strukturën e mureve;
- Konservimi i elementeve origjinale: porta metalike në hyrje, dera e drurit në përdhës, dritaret në përdhës, elementet origjinale të enterierit në përdhës, dhe elementet tjera metalike në terrasë dhe oborr;
- Rindërtimi i dritareve të reja nga druri në kat, duke u bazuar në dimensionet dhe modelin e atyre ekzistues.

- Restaurimi i oborrit dhe shtigjeve për ecje.

Nga punët e parapara në projekt, këto pozicione nuk janë kryer:

- Ndërtimi i shtegut me shkallë dhe rampë nga rruga deri te ura;
- Ndërtimi i rampës nga oborri deri në nyjet sanitare;
- Punët në enterier që ndërlidhen me ri-funksionalizimin e ndërtesës si muze:
 - o Vendosja e ndriçimit të dizajnuar enkas për ndërtesën;
 - o Vendosja e konstruksionit mbajtës për panelet e ekspozitës;
 - o Vendosja e tabelave informuese për eksponatet e muzeut;

Nevojiten fonde shtesë për të siguruar adaptimin e ndërtesës për akomodim të funksionit të muzeut, bazuar në standardet bashkëkohore.

Faktorët ndikues ndaj asetit

Faktorët natyror – Hidroelektrana në anën jugore është e mbështetur mbi shpatin shkëmbor të malit. Rrjedha e lumit në anën veriore, orientimi verior, dhe shpati shkëmbor i cili e rrethon ndërtesën kah ana jugore paraqiten si faktorë permanent natyror të cilët kërcënojnë stabilitetin e ndërtesës, nëpërmjet pranisë së lagështisë.

Faktori njeri – aspekti ligjor – Hidroelektrana edhe pse në Listën e trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të përkohshme quhet me emërtimin: “Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë”, ajo në aspektin ligjor nuk e ka statusin e muzeut.

Mungesa e ligjit për Muze dhe planit të menaxhimit për ndërtesën, paraqet njërin prej faktorëve kryesor që rrezikon ri-funksionalizimin e kësaj ndërtese.

Faktori njeri - Mungesa e funksionit dhe mirëmbajtjes – mungesa e funksionit të Hidroelektranës, si rrjedhojë mungesa e mirëmbajtjes së rregullt rrezikon dëmtimin e strukturës tashmë të konservuar.

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershëm mbi statusin ligjor të asetit.*
- *Shtojcë 1, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Shtojca 2, Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, P=1:200 dhe P =1:500, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*
- *Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200,*

përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

- **Shtojcë 4: Plani i Menaxhimit**

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prizren

Hartuesit e formularit: Jusuf Xhibo - ida. & MSc. Arkeologji
Nora Arapi Krasniqi - Bark. MSc. Konservim


Personi i autorizuar:

Adresa dhe kontakti:



Data: .../.../.....

Nënshkrimi:

Fotografitë e vjetra



Hidroelektrana gjatë vitit 1930 (nga arkivi i QRTK Prizren)



Planet originale të ndërtesës (nga arkivi i QRTK Prizren)



Hidroelektrana gjatë vitit 1960 (nga arkivi i QRTK Prizren)



Hidroelektrana gjatë vitit 1979 (nga arkivi i QRTK Prizren)

*Fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit
Pamjet aktuale karakteristike_viti 2015*



Hyrja në Hidroelektranë



Pamje verilindore e ndërtesës dhe oborri



Pamje verilindore



Pamje lindore



Pamje juglindore





Pamje e oborrit



Qasja në ndërtesë dhe ura



Pamje e terrasës



Dhoma e gjeneratorëve në përdhes



Hapësira e nënkulmit



Dhoma në kat



Konstruksioni meskatësh nga betonarmeja